



# BE LAJME



**BE QENDRA**  
**Tetor -2024**  
**BEQ-numër 94/2024**

## 20 VITE NGA ANËTARËSIMI NË BASHKIMIN EVROPIAN



20 vjet më parë, më 1 maj 2004, shtetas të BE-së u bënë qytetarët e Qipros, Republikës Çeke, Estonisë, Hungarisë, Letonisë, Lituanisë, Maltës, Polonisë, Sllovakisë dhe Sllovenisë. Bashkimi Evropian është bërë një entitet më i madh politik, ekonomik dhe kulturor. Disa vite më vonë, u bashëngjitën Bullgaria, Rumania dhe Kroacia.

Me ndryshimet në të gjithë BE-në në dy dekadat e fundit, qytetarët kanë të drejta dhe liri më të forta. Demokracia dhe sundimi i së drejtës janë forcuar, mundësitë për njerëzit dhe biznesin janë shtuar. Që nga viti 2004, mbi 2.7 milionë të rinj nga 10 shtetet anëtare kanë marrë pjesë në programin Erasmus+.

Që nga anëtarësimi në BE, 10 shtetet anëtare kanë rritur riciklimin e mbetjeve komunale. Nga viti 2004 deri në vitin 2022, Sllovakia, Lituania, Sllovenia dhe Letonia raportuan një rritje prej më shumë se 40% në normat e tyre të riciklimin.

Jetëgjatësia mesatare në vendet që nga zgjerimi i vitit 2004 është rritur nga 75 vjet në 79 vjet, pothuajse duke mbyllur hendekun me mesataren e BE -27 prej 81 vjetësh.

Sipas Eurobarometrit të fundit, në vendet anëtare që u bashkuan BE-së 20 vjet më parë, kënaqësia nga jeta është rritur nga 68% në 2004 në 89% në 2024.

Gjatë 20 viteve të fundit, ekonomia e BE-së është rritur me 27%. Ekonomitë polake dhe malteze u dyfishuan dhe Sllovakia u rrit me 80%.

Ekonomitë e të gjitha shteteve më të reja anëtare po i afrohen në mënyrë të qëndrueshme mesatares së BE-27.

Sllovenia ishte e para që miratoi euron në vitin 2007, ndërsa Lituania e miratoi atë në 2015. Kjo u mundësoi më shumë bizneseve dhe qytetarëve të gëzojnë përfitimet e plota të tregut të vetëm pa rreziqe të kursit të këmbimit.

Me mbështetjen e financimit të politikës së kohezionit të BE-së dhe Mekanizmit "Lidhje e Evropës", rrjeti i transportit të Evropës është transformuar dhe zgjeruar. Gjatësia e autostradave është trefishuar në Poloni, Hungari dhe Sllovaki në dy dekadat e fundit. Që nga viti 2004, rrjeti hekurudhor i Lituanisë është zgjeruar me 200 km.

Në 20 vitet e fundit, BE-ja ka arritur të përmirësojë efikasitetin energjetik të ekonomisë së saj. Në tërësi, BE-ja uli intensitetin energjetik të ekonomisë së saj me pothuajse 33%.

Zëri i Evropës në skenën botërore është bërë më i fortë - duke ndërmarrë veprime për ndryshimet klimatike, duke luftuar pandeminë dhe duke promovuar demokracinë.

Tregu i vetëm më i madh e ka bërë BE -në një partner tregtar edhe më tërheqës, duke krijuar mundësi të reja jashtë vendit. Që nga viti 2004, tregtia ndërkombëtare globale e Evropës është zgjeruar me 3 trilionë euro - duke arritur në 5 trilionë euro në vitin 2023.

<https://commission.europa.eu>

### Përmbajtja e lajmeve:

20 vite nga anëtarësimi në Bashkimin Evropian	1
Në fokus të Parlamentit Evropian	2
Zgjedhje Parlamentare në Austri	3
Strategjia e BE-së për barazi	3
Aktivitetet Parlamentare lidhur me çështjet Evropiane	4-5
Përbërja e re e Komisionit Evropian	6
Bashkëpunim më i madh ndërmjet Agjencive Shëndetësore të BE-së	6
Dita ndërkombëtare e demokracisë	7
Marrëveshje për Intelejencë Artificiale	7
Eurobarometri Hulumtim 2024	8
Takim i Këshillit për punë të përgjithshme të BE-	8
Ndihmë për bujqit në BE	9
Politikë e rreptë për azil në Holandë	9
Sateliti i lansuar Evropian "COPERNICUS SENTINEL 2-C"	10
Ndalese për huazuesit e trotinetëve elektrik në Madrid	10
Ngadalësohet rritja rrogave në BE	11
Rrënie e importit të energjensëve në BE	11
BE KALENDAR / tetor 2024	11



[www.europarl.europa.eu](http://www.europarl.europa.eu)

### Sesioni plenar 16-19 shtator 2024

Kryetarja e PE, Roberta Meola, hapi seancën plenare nga 16 deri më 19 shtator në Strasburg. Mario Dragi, ish-kryeministri italian dhe ish-kryetari i Bankës Qendrore Evropiane, prezantoi para eurodeputetëve një plan për të përmirësuar konkurrencën e Evropës përmes bashkëpunimit më të ngushtë në fushat kryesore dhe investimeve të mëdha në qëllimet e përbashkëta.

Parlamenti Evropian hodhi poshtë dy vendime të Komisionit Evropian që lejojnë tolerancat e importit për ciprokonazolin dhe spirodiklofenin në ose për sasi të mëdha produktesh si drithërat, farat, mishi, mëlçia dhe veshkat, si dhe për benomyl, karbendazim dhe tiofanat-metil në ose për produkte të caktuara të tilla si limon, limes, mandarina dhe bamje. Përdorimi i këtyre pesticideve tashmë është i ndaluar në BE. Parlamenti Evropian në mandatin aktual legjislativ do të ketë 48 delegacione ndërparlamentare - katër më shumë se në mandatin e kaluar. Procesi për krijimin e delegacioneve në Parlament është përcaktuar në rregullin 229 të Rregullores së Punës, sipas të cilit përbërja e delegacioneve duhet të sigurojë që sa më shumë shtete anëtare, pikëpamjet politike dhe përfaqësimi gjinor të përfaqësohen në mënyrë të drejtë dhe asnjë delegacion nuk duhet të ketë më shumë se 1/3 e eurodeputetëve që vijnë nga i njëjti vend.

Parlamenti Evropian miratoi tre rezoluta për çështjet e të drejtave të njeriut në Afganistan, Bjellorusi dhe Kubë.

Në një rezolutë të miratuar me 425 vota, eurodeputetët kërkuan që vendet e BE të heqin kufizimet që pengojnë Ukrainën të përdorë sistemet e armëve perëndimore kundër objektivave legjitime ushtarake në Rusi.

Në një rezolutë të miratuar mbi përmbytjet shkatërruese në Austri, Republikën Çeke, Gjermani, Hungari, Poloni, Rumania dhe Sllovaki, eurodeputetët shprehën shqetësimin për shkurtime të fundit të buxhetit ndaj Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së. Ata kërkuan financim adekuat dhe të përmirësuar për të rritur gatishmërinë

dhe për të përmirësuar kapacitetet, me referencë të veçantë për buxhetin e ardhshëm shumëvjeçar të BE-së. Në terma afatgjatë, rezoluta bën thirrje për investime më të mëdha të BE-së në qëndrueshmërinë rajonale dhe lokale dhe bën thirrje që politika e ardhshme e kohezionit të BE-së të fokusohet edhe më shumë në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Në rezolutën e miratuar me 309 vota, Parlamenti Evropian "dënon fuqishëm dhe hedh poshtë plotësisht mashtrimin zgjedhor të organizuar nga Këshilli Nacional Zgjedhor i kontrolluar nga regjimi, i cili refuzoi të shpallë publikisht rezultatin zyrtar". Eurodeputetët e njohin Edmundo Gonzales Urutija-n si presidentin legjitim dhe të zgjedhur në mënyrë demokratike të Venezuelës dhe Marija Korina Maçado-n si udhëheqësen e forcave demokratike.

Grupet politike të Parlamentit Evropian prezantuan kandidatët e tyre për çmimin Saharov 2024. Në tetor të këtij viti do të zgjidhen tre finalistë.

Kandidatët për Çmimin Saharov 2024, nderimi më i lartë i BE-së për punën e të drejtave të njeriut, janë: Marija Korina Maçado; "Gratë udhëheqin paqen" dhe "Gratë e diellit", Izrael/Palestinë; Ilon Mask, SHBA; Edmundo Gonzales Urutija, Venezuelë; Women Wage Peace & Women of the Sun, Izrael/Palestinë; Dr. Gubad Ibadoglu, Azerbajxhan; dhe Gazetarët në Palestinë.

## ZGJEDHJE PARLAMENTARE NË AUSTRI

Më 29 shtator të këtij viti në Austri u mbajtën zgjedhjet parlamentare për 183 anëtarë të Dhomës së Ulët të Parlamentit austriak.

Rezultatet zyrtare paraprake treguan se Partia e Lirisë përfundoi e para me 29.2% të votave dhe Partia Popullore Austriake ishte e dyta me 26.5%. Në vendin e tretë janë socialdemokratët e majtë me 21%.

Në programin e saj elektorale, të titulluar "Fortesa e Austrisë", Partia e Lirisë bën thirrje për "Riemigrimin e të huajve të paftuar", për të arritur një komb më "homogjen" përmes kontrollit të rreptë të kufijve dhe pezullimit të së drejtës për azil përmes ligjit të emergjencës.

Partia Austriake e Lirisë FPO do të duhet të formojë një koalicion me një ose më shumë parti për të siguruar një shumicë parlamentare dhe një qeveri të qëndrueshme

Më shumë se 6.3 milionë qytetarë austriakë kishin të drejtë të votonin për parlamentin e ri në Austri, një anëtar i BE-së me një politikë neutraliteti ushtarak.

<https://edition.cnn.com/>

## STRATEGJIA E BE-SË PËR BARAZI

Më 25 shtator 2024, Komisioni Evropian miratoi 3 raporte mbi strategjitë kryesore që synojnë përfundimin e diskriminimit dhe ndërtimin e një Unioni të Barazisë: Plani i Veprimit të BE-së kundër Racizmit 2020-2025, Kuadri Strategjik i BE-së për Romët 2020-2030 dhe Strategjia e Barazisë LGBTIK 2020- 2025.

Raportet theksojnë përparimin në përcaktimin e planeve nacionale të veprimit kundër racizmit, mbështetjen e forcuar për komunitetet rome dhe reduktimin e diskriminimit LGBTIK.

Shtetet Anëtare të BE-së inkurajohen të miratojnë dhe ofrojnë strategji nacionale dhe plane veprimi për të nxitur përfshirjen, për të trajtuar diskriminimin strukturor dhe për të rritur financimin dhe burimet administrative.

Për më tepër, raportet treguan se shtetet anëtare duhet të forcojnë mbledhjen e të dhënave dhe të miratojnë objektiva ambicioze për vlerësimin e progresit në përfshirjen e romëve, i cili ende konsiderohet i pamjaftueshëm.

Zëvendës-kryetarja e KE-së për vlerat dhe transparencën, Vera Jourova, vuri në dukje: "Raportet tona tregojnë shumë arritje, duke përfshirë miratimin e ligjeve kyçe, planeve nacionale të veprimit dhe strategjive apo programeve të financimit.



**Together  
for equality  
Stronger  
for all**

Në vitin 2008, racizmi dhe ksenofobia u bënë vepra penale në BE. Duke parë përpara, shtetet anëtare do të përmbushin standarde të reja detyruese për organet e barazisë. Në mandatin e ardhshëm, Kryetarja e Komisionit Evropian, Ursula Von der Leyen, ka shprehur synimin e saj për të ngarkuar Komisionerin që të propozojë një strategji të rinovuar të barazisë LGBTIK për pas vitit 2025, duke paraqitur një strategji të re kundër racizmit dhe duke udhëhequr zbatimin e Kornizës Strategjike e BE-së për barazinë e romëve.

<https://commission.europa.eu>

## AKTIVITETE TË KUVENDIT LIDHUR ME ÇËSHTJET EVROPIANE



Më 24 shtator 2024, kryetari i Kuvendit, Afrim Gashi, së bashku me nënkryetarin e Kuvendit dhe kryetar të Komisionit për Çështje Evropiane, Antonijo Milloshoski dhe kryetaren e Komisionit për Financim dhe Buxhet, Sanja Lukarevska, mbajti një takim të përbashkët me Laima Lucia Andrikiene, një anëtare e Gjykatës Evropiane të revizorëve. Në fokus të takimit ishte Plani i Rritjes së Ballkanit Perëndimor dhe përfitimet e pritura nga zbatimi i tij në procesin e integritimit evropian të rajonit dhe vendit tonë. Në takim u shkëmbyen mendime për agjendat reformuese të vendeve të rajonit, miratimi i të cilave në institucionet e BE-së është parakusht për realizimin e ndihmës financiare.

[www.sobranie.mk](http://www.sobranie.mk)

Më 23 shtator 2024, Kryetari Gashi zhvilloi një takim me Kryetaren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Elisa Spiropali. Në takim, Gashi theksoi se pret që miqësia dhe bashkëpunimi i sinqertë mes dy vendeve të forcohet dhe avancohet edhe më shumë. Kryetarja Spiropali theksoi se Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Shqipëria janë dy vende mike që ndajnë të njëjtat vlera, vizione dhe sfida, kanë një rrugëtim të përbashkët drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.



Më 16 shtator 2024, Kryetari Gashi zhvilloi një takim me kryetarin e Institutit Suprem Revizor të Republikës Çeke, Miroslav Kalla, ku ishte i pranishëm edhe Maksim Acevski, drejtor i Entit Shtetëror për Revizion (ESHR). Gashi në takim theksoi hapjen e Kuvendit për bashkëpunim me ESHR-në dhe se takimi ka për qëllim gjetjen e mënyrave dhe sferave të reja për zgjerimin e bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet dy enteve dhe Kuvendit.

Nënkryetari i Kuvendit, Antonijo Milloshoski, më 12 shtator 2024 mbajti një takim pune me Dr. Mark Shpic, sekretar shtetërorë për çështjet federale, ndërkombëtare dhe politike mediatike të Rajna-Vestfalia e Veriut. Në takim, bashkëbiseduesit shkëmbyen mendime rreth procesit integruar të vendit tonë në Bashkimin Evropian dhe mundësive për thellimin e bashkëpunimit të mirë tradicional në plan dypalësh. Në takim u theksua rëndësia e integritimit të vendeve të rajonit në Bashkimin Evropian.



AKTIVITETE TË KUVENDIT LIDHUR ME ÇËSHTJET EVROPIANE

Më 26 shtator 2024, nënkryetari i Kuvendit dhe kryetar i Komisionit për Çështje Evropiane, Antonijo Milloshoski dhe kryetarja e Grupit Parlamentar të Kuvendit për bashkëpunim me parlamentet e shteteve baltike, Monika Zajkova, mbajtën një takim me delegacionin e Letonisë të kryesuar nga Ingrida Levrens, zëvendës sekretare shtetërore për Çështjet Evropiane dhe Shefe e Drejtorisë së BE-së. Në takim, Milloshoski i njoftoi mysafirët me sfidat me të cilat po përballen vendi në rrugën e integritimit evropian, duke filluar nga kontesti me Greqinë dhe ndryshimi i emrit, përmes propozimit francez dhe vetos aktuale bullgare. Në këtë rast, ndërprerja e procesit të anëtarësimit në BE nuk bazohet në kriteret e Kopenhagës, por në çështjet bilaterale, të cilat mund të zgjidhen sipas shembullit të kontestit kroato-sloven, theksoi Milloshoski.



Komisioni për Çështje Ekonomike, Punë dhe Politikë Energjetike më 16 shtator 2024 ka mbajtur një takim me deputetë të Komisionit për Punë dhe Politikë Sociale nga Bundestagu Gjerman, në të cilin janë shkëmbyer përvojat në fushën e punës që janë nën juridiksionin e komisioneve nga të dyja vendet. Në takim u shpreh se nevojitet siguri më e madhe për punëtorët dhe reforma e sistemit arsimor që do të mundësojë krijimin e kuadrove të kërkuara në tregun e punës. Gjithashtu, u bë propozim për formimin e grupit punues nga Komisioni, i cili do të bëjë një vizitë kthyesë në Bundestag, me qëllim shkëmbimin e përvojave në fushën e punës me kolegët gjermanë, të cilat do të mund të transferohen në legjislacionin e Maqedonisë. Takimi punues me përfaqësues të Komisionit për Politikë Sociale, Demografi dhe të Rinj.



Delegacioni nga Komisioni për Mbrojtje dhe Siguri dhe Komisioni për Punë të Jashtme të Kuvendit në përbërje: Pavle Arsoski, Musa Xhaferi, Marija Petrushevska dhe Rexhep Ismail mori pjesë në Konferencën Ndërparlamentare për Politikë të Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, e cila u mbajt më 9-10 shtator 2024 në Budapest, Hungari. Pjesëmarrësit e konferencës debatuan për sfidat globale me të cilat përballen Bashkimi Evropian, perspektivën evropiane të vendeve candidate për anëtarësim në BE dhe forcimin e bashkëpunimit dhe industrisë evropiane të mbrojtjes. Fjalim mbajtën deputetja Marija Petrushevska dhe deputeti Pavle Arsoski.



## PËRBËRJA E RE E KOMISIONIT EVROPIAN



Kryetarja e Komisionit Evropian, Ursula fon der Lajen, e cila u zgjodh për një mandat të dytë, më 18 korrik të këtij viti prezantoi para eurodeputetëve udhëzimet e saj politike për Komisionin e ardhshëm Evropian 2024-2029. Më 17 shtator, ajo dorëzoi një listë të komisionerëve të emëruar dhe përcaktoi portofolet e tyre, duke reflektuar ambicet e përcaktuara në Udhëzimet e Politikave.

Komisionerët e emëruar marrin pjesë në një seancë publike në Parlamentin Evropian. Pastaj Komisioni në tërësi miratohet nga Parlamenti Evropian. Këshilli Evropian, duke vepruar me shumicë të cilësuar, emëron zyrtarisht udhëheqjen e re të Komisionit.

Rafaele Fito nga Italia do të marrë postin kyç të nënkryetarit përgjegjës për ekonominë në Komisionin e ri Evropian.

Letonia Valdis Dombrovskis, francezi Tjeri Breton dhe spanjollja Teresa Ribera do të marrin gjithashtu poste nënkryetare në KE-në e re. Për nga funksioni, nënkryetari ekzekutiv i KE-së është edhe përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikën e jashtme dhe sigurinë, detyrë që do t'i takonte estonezes, Kaja Kalas.

Dombrovskis do të ishte në krye të zgjerimit të BE-së dhe rindërtimit të Ukrainës, ndërsa Bretoni do të merrte resoret e industrisë dhe autonomisë strategjike. Marosh Shefçoviç do të mbante resorin për çështjet ndërinstitucionale, por nuk do të ishte më nënkryetar ekzekutiv i KE-së. Çeku Jozef Sikela do të merrte resorin e energjisë dhe polaku Pjotr Serafin do të merrej me çështjet e buxhetit.

Me propozimin e Roksana Minzatu nga Rumania dhe Haxha Labib nga Belgjika, Komisioni i ri Evropian mund të ketë 10 gra nga gjithsej 27 anëtarë. Zëvendës-zëdhënësja kryesore e Komisionit Evropian, Arijana Podesta, tha se Fon der Lajen mbetet në pozicionin e vet për të siguruar barazinë gjinore në përbërjen e ardhshme të Kolegjit të Komisionerëve dhe për ta arritur këtë ajo është në kontakt të vazhdueshëm me të gjithë drejtuesit e shteteve anëtare.

<https://www.eunews.it/en/>

## BASHKËPUNIM MË I MADH NDËRMJET AGJENCIVE SHËNDETËSORE TË BE-së



Raporti i Gjykatës Evropiane të Revizorëve (ECA) analizon reagimin e agjencive evropiane shëndetësore ndaj krizës së Covid dhe thekson nevojën për bashkëpunim më të ngushtë midis Qendrës Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC), Agjencinë Evropiane të Barnave (EMA) dhe Agjencia Evropiane e Barnave për përgjigjen emergjente shëndetësore (HERA). Kjo për të shmangur mbivendosjen e kompetencave dhe për të siguruar një përgjigje më të mirë të koordinuar të BE-së ndaj pandemive të mundshme të ardhshme dhe krizave mjekësore.

Për ECDC-në, revizorët rekomandojnë përmirësimin e nivelit të bashkëpunimit me shtetet anëtare të BE-së duke krijuar një sistem më të fortë mbikëqyrjeje, i cili do të vendosë përkufizime të përbashkëta brenda

Bashkimit dhe do të mundësojë komunikim më të mirë me publikun. Revizorët gjithashtu bëjnë thirrje për organizim më të mirë të ECDC dhe racionalizim të procedurave të tij të brendshme.

Për sa i përket HERA-s, e cila u krijua në vitin 2021 për të ndihmuar BE-në të reagojë shpejt ndaj emergjencave shëndetësore, revizorët rekomandojnë që nevojitet sqarimi i rolit të saktë të organizmit.

Sipas Gjykatës së Revizorit, masa të tilla "sigurisht plotësojnë disa boshllëqe" në kapacitetin e BE-së për t'iu përgjigjur urgjencave shëndetësore, duke rezultuar në një "kornizë organizative më komplekse".

<https://www.eca.europa.eu/en>

## DITA NDËRKOMBËTARE E DEMOKRACISË


Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Demokracisë - 15 shtator, në deklaratën e përbashkët të Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Zhosep Borel, dhe nëkryetares së Komisionit Evropian për Demokraci dhe Demografi, Dubravka Šuica, theksoi se Bashkimi Evropian mbetet i vendosur në angazhimin e tij për të forcuar dhe mbrojtur demokracinë, brenda dhe jashtë kufijve të tij.

Në këtë Ditë Ndërkombëtare të Demokracisë, BE-ja rikonfirmon mbështetjen e saj për të gjithë ata që mbrojnë vlerat demokratike dhe të drejtat universale dhe thekson përgjegjësinë kolektive për të ndërtuar shoqëri elastike, gjithëpërfshirëse për

brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Ruajtja e demokracisë është çelësi për ruajtjen dhe promovimin e dinjitetit të çdo qytetari, si dhe inkurajimin e drejtësisë sociale, zhvillimit gjithëpërfshirës dhe paqes, thekson mesazhi.

Borel dhe Šuica theksuan se në rajone të ndryshme të botës, njerëzit përballen me kërcënime dhe përpjekje për të minuar proceset demokratike, integritetin e zgjedhjeve dhe themelet e demokracisë përmes dhunës politike, manipulimit elektoral, mashtrimit, keqpërdorimit të burimeve shtetërore, përhapjes së dezinformatave apo ndërhyrjeve të huaja.

BE-ja mbështet shoqërinë civile dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut, lufton korrupsionin, përpiqet të përmirësojë sundimin e të drejtës dhe mbështet mediat e pavarura, sigurinë e gazetarëve dhe luftën kundër dezinformimit, njëkohësisht duke promovuar një transformim të drejtë digjital.



<https://www.eeas.europa.eu/>

## MARRËVESHJE PËR INTELIGJENCË ARTIFICIALE

Komisioni Evropian ka nënshkruar Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Inteligjencën Artificiale, e cila thekson të drejtat e njeriut dhe vlerat demokratike në qasjen e tij ndaj rregullimit të sistemeve të sektorit publik dhe privat.

Konventa, e cila ka një karakter ligjor detyrues, u përgatit për më shumë se dy vjet. Më shumë se 50 vende morën pjesë në përgatitje, duke përfshirë Kanadanë, Izraelin, Japoninë dhe Australinë, shton "Fajnenshëll Tajms.

Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Inteligjencën Artificiale, të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Sundimin e të Drejtës u miratua nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës më 17 maj 2024.

Shtetet që dëshirojnë të nënshkruajnë marrëveshjen ndërkombëtare kanë mundësinë ta bëjnë këtë nga 5 shtatori, në Vilnius, kryeqyteti i Lituaniës.

Më shumë se njëqind kompani kanë nënshkruar deri më tani Paktin për Inteligjencën Artificiale të BE-së, duke u zotuar kështu vullnetarisht të respektojnë dispozitat e tij përpara fillimit të aplikimit të tyre ligjor, njoftoi sot Komisioni Evropian.

Nënshkruesit përfshijnë korporata multinacionale dhe ndërmarrje evropiane të vogla dhe të mesme nga sektorë të ndryshëm, duke përfshirë IT, telekomunikacionin, kujdesin shëndetësor, bankat, industrinë automobilistike dhe aeronautikën.



<https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/news>

## EUROBAROMETRI HULUMTIM 2024



Rezultatet e sondazhit të fundit të Eurobarometrit të publikuar më 24 shtator të këtij viti tregojnë se qytetarët evropianë mbështesin politikën energjetike të BE-së dhe shprehin mbështetje të fortë për një koordinim më të madh dhe përpjekje shtesë në këtë sferë. Kjo për të siguruar çmime më të përballeshme të energjisë, paralelisht me kalimin në energji të pastër dhe arritjen e pavarësisë energjetike të bllokut.

Sipas sondazhit, 79% e evropianëve janë të mendimit se arritja e synimeve të BE-së për klimë do të inkurajojë krijimin e vendeve të reja të punës dhe tërheqjen e investimeve në sektorin e prodhimit të energjisë së pastër, 77% besojnë se Bashkimi Evropian duhet të ketë rol koordinimi më të madh në

çështjet e energjisë, dhe 76% besojnë se politikat aktuale të bllokut do të reduktojnë varësinë nga importet e energjisë.

Rreth 69% mendojnë se politika energjetike e BE-së do të sigurojë një ulje të faturave të energjisë për familjet dhe bizneset, 62% mendojnë se Bashkimi duhet të diversifikojë burimet e tij të energjisë, kryesisht duke investuar në prodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme, dhe 54% janë të mendimit se është e nevojshme të kursehet energjia elektrike sa herë që është e mundur.

Në reagim ndaj rezultateve të hulumtimit, Komisioni Evropian vlerësoi se ato pasqyrojnë ambicet e tij për periudhën 2024-2029.

<https://europa.eu/newsroom/>

## TAKIM I KËSHILLIT PËR PUNË TË PËRGJITHSHME TË BE-SË



Si pjesë e dialogut vjetor të Këshillit, më 24 shtator 2024 ministrat zhvilluan një diskutim mbi sundimin e të drejtës në BE. Debati u fokusua në 4 fusha që lidhen me sundimin e së drejtës: sistemi i drejtësisë, kuadri antikorrupsion, pluralizmi dhe liria e medias çështje tjera.

Sundimi i ligjit ka një rol qendror në procesin e zgjerimit si kusht themelor për anëtarësimin në BE. Këtë vit, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, si vende candidate më të përparuara në procesin e qasjes dhe në lidhje me nivelin e përgatitjes për sundimin e të drejtës, për herë të parë u përfshinë në raportin e Komisionit për Sundimi e të Drejtës.

Ministrat zhvilluan një shkëmbim të përgjithshëm mbi çështjet e sundimit të së drejtës me këto vende candidate, të udhëhequr nga kapitulli horizontal i raportit të Komisionit për 2024-ën. Diskutimi u fokusua vetëm në

trendet e përgjithshme për sundimin e të drejtës dhe pas debatit nuk u miratuan konkluzione zyrtare. Diskutimet për sundimin e ligjit në vendet candidate do të vazhdojnë të zhvillohen në kuadër të procesit të zgjerimit. Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së ka filluar përgatitjet për takimin e Këshillit Evropian të planifikuar për 17-18 tetor të këtij viti dhe për draft agjendën.

<https://newsroom.consilium.europa.eu>



## NDIHMË PËR BUJQIT NË BE

Komisioni Evropian propozoi nga të ashtuquajturat Rezervat bujqësore të BE-së do të ndajnë 119.7 milionë euro si mbështetje direkte për bujqit nga Bullgaria, Gjermania, Estonia, Italia dhe Rumania, të cilët u prekën nga ngjarje jashtëzakonisht të pafavorshme klimatike gjatë pranverës dhe fillimit të verës të këtij viti. Sipas propozimit të KE-së, në shenjë solidariteti duhet të ndahen 10,9 milionë euro për Bullgarinë, 46,5 milionë euro për Gjermaninë, 3,3 milionë për Estoninë, 37,4 milionë për Italinë dhe 21,6 milionë euro për Rumaninë në këto vende që pësuan dëme në prodhimin dhe të ardhurat e tyre si pasojë e fatkeqësive të motit. Këto shuma mund të plotësohen me mjete nga buxhetet nacionale deri në 200%. Nëse propozimi i Komisionit Evropian miratohet nga shtetet anëtare në takimin e Komitetit për Organizimin e Përbashkët të Tregjeve Bujqësore të planifikuar për më 7 tetor, pesë vendet për të cilat synohet ndihma, do të kenë kohë deri më 31 dhjetor të informojnë Brukselin për kriteret e ndarjes veçmas, për një plan për pagesën e mjeteve dhe për ofrimin eventual të mbështetjes shtesë për bujqit e dëmtuar.

Fondet e ndihmës duhet t'u shpërndahen bujqve të prekur jo më vonë se data 30 Prill 2025, ndërkohë që duhet pasur kujdes që të mos shkaktohet cenim i parimeve të konkurrencës me kompensim të tepruar.



<https://ec.europa.eu/commission/>

## POLITIKË E RREPTË PËR AZIL NË HOLANDË

Më 13 shtator të këtij viti, qeveria holandeze njoftoi synimin e saj për të futur politikën më të rreptë të azilit në historinë e Holandës.

Ministri i krahut të djathtë për Azilin dhe Migracionin, Marjolein Faber, tha se shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme do të lejonte qeverinë holandeze të pezullonte "shumë shpejt" pjesë të ligjeve ekzistuese të azilit. Kjo është për të kufizuar numrin e azilkërkesve që hyjnë në vend.

Qeveria ka njoftuar se do të ndalojë pagesat e bane-save për personat, kërkesat për azil të cilëve janë refuzuar. Në fillim të shtatorit, ministri Faber njoftoi se financimi shtetëror për strehimin për "njerëzit që duhet të ishin larguar shumë kohë më parë" do të ndërpritet deri më 1 janar 2025.

Rreth 40,000 azilkërkes mbërrijnë në Holandë çdo vit, gjë që kritikët thonë se po përkeqëson mungesën e strehimit në vend.

Qeveria holandeze mund të përdorë një dekret mbretëror për të vendosur një gjendje të jashtëzakonshme në rast krize, duke e lejuar atë të marrë masa pa miratimin e Parlamentit siç ndodhi gjatë pandemisë së koronavirusit.



<https://ecre.org/netherlands>

## SATELITI I LANCUAR EVROPIAN "KOPERNIKUS SENTINEL 2-C"



Komisioni Evropian raportoi se "Sentinel 2-C" do të japë të dhënat më të fundit dhe do të ofrojë shërbime të vëzhgimit të Tokës për nevojat e shërbimeve publike dhe përdoruesve privatë.

Të dhënat e përditësuara të marra nga sateliti do të ndihmojnë entet publike dhe private të marrin vendime më të përshtatshme dhe të përballen më mirë me sfidat urgjente ekologjike, si zjarret në pyje, përmytjet dhe thatësitrat. Fushat e tjera që do të përfitojnë nga këto të dhëna përfshijnë bujqësinë, detarinë dhe pylltarinë.

Sentinel 2-C do të shtojë sistemin më të përparuar të vëzhgimit të Tokës në botë "Kopernikus. Ai do të kalibrohet në muajt e ardhshëm, pas së cilës do të bëhet

plotësisht funksional dhe do të fillojë të japë të dhëna të lidhura me Tokën.

Tashmë më 13 shtator 2024, një javë pas lëshimit të tij, sateliti Kopernik Sentinel-2C filloi të japë imazhe të planetit Tokë.

Shtimi i Sentinel-2C në familjen Copernicus Sentinel siguron që Copernicus të vazhdojë të ofrojë të dhëna kyçe që u shërbejnë nevojave të komunitetit të përdoruesve dhe mbështesin një gamë të gjerë aplikacionesh për vitet në vijim.

Projekti u zbatua në bashkëpunim mes Agjencisë Evropiane të Hapësirës dhe kompanisë private franceze "Ariana Spejs", e cila zotëron raketën "Vega".

<https://www.copernicus.eu/>

## NDALESË PËR HUAZUESIT E TROTINETËVE ELEKTRIK NË MADRID



Qyteti i Madridit ka njoftuar se do të ndalojë marrjen me qira të skuterëve elektrikë, duke u bërë kryeqyteti i dytë evropian pas Parisit që merr këtë masë për shkak të numrit në rritje të aksidenteve në të cilat këmbësorët janë viktimat më të zakonshme.

Qeveria e qytetit të Madridit tha se ndalimi do të hyjë në fuqi më 1 tetor.

"Ne po tërheqim të gjitha lejet që kompanitë të marrin me qira e-skuterë në rrugët e qytetit," shkroi në rrjetin iks kryetari konservator i Madridit, Luis Martinez Almeida. Ai theksoi se prioritet është siguria e qytetarëve të Madridit.

Këshilli i qytetit vuri në dukje se kompanitë bllokuan përpjekjet për të verifikuar operacionet e tyre duke

mos ofruar informacionin e nevojshëm ose duke lejuar akses në ndërfaqet e tyre. Megjithatë, pushteti i qytetit arriti të përcaktojë se ata nuk i plotësonin kushtet e lejeve. Defektet përfshijnë mungesën e shërbimit në të gjithë qytetin, mungesën e mbulimit të sigurimit dhe mungesën e teknologjisë që pengon automjetet të qarkullojnë ose të parkojnë në zona të kufizuara

"Tri kompanitë që kanë licencë për të marrë me qira 6000 skuterë elektrikë do të duhet t'i heqin nga rruga sepse nuk kanë përmbushur kushtin që kemi vendosur – për të garantuar sigurinë e këmbësorëve, veçanërisht të të moshuarve", tha kryetari i komunës.

Skuterët elektrikë privatë mbeten të ligjshëm në qytet, sipas faqes së internetit të bashkisë.

<https://edition.cnn.com>

NGADALËSOHET RITJJA E RROGAVE NË BE

Ritja e pagave në eurozonë po ngadalësohet pasi punëdhënësit ulën bonuset, tregoi një sondazh i Bankës Qendrore Evropiane (BQE).

Punëdhënësit kohët e fundit filluan të shkurtojnë pagat dhe shpërblimet jashtë orarit për të përshtatur pagat me inflacionin.

Në periudhën prill-qershor të këtij viti, pagat e rëna dakord janë rritur në fushën e aplikimit të monedhës së përbashkët evropiane me 4.3%, sipas të dhënave të BQE.

Në tre muajt e parë të vitit, ato u rritën me 4.7%. Megjithatë, rritja e tyre në tremujorin e pranverës ishte më e fortë se sa do të duhej për të ulur normën e inflacionit në 2%. Banka Qendrore Evropiane vlerëson se rritja e çmimeve do të dobësohet dhe do të arrijë nivelin e synuar në gjysmën e dytë të vitit të ardhshëm.

Në mbledhjen e shtatorit, BQE doli në përfundimin se kishte frenuar konsumin e brendshëm me një politikë monetare kufizuese, duke ulur vlerësimin për rritjen e aktivitetit ekonomik këtë vit në 0.8%. Në vitin 2025, sipas vlerësimeve të tyre, aktiviteti ekonomik duhet të përshpejtohet vetëm pak, me një normë rritjeje të parashikuar prej 1.3%.



<https://biznis.rs/>

RRËNIE E IMPORTIT TË ENERJENSËVE NË BE



Në tremujorin e dytë të vitit 2024, BE importoi gjithsej 177.9 milionë tonë energji me vlerë 94.9 miliardë euro, që paraqet një rënie në sasi në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar me 9.7% dhe në vlerë me 10.7%.

Sipas të dhënave të Eurostat, sasi të importuara të gazit natyror në tremujorin e dytë të këtij viti u ulën me 9.5% në nivel vjetor dhe vlera totale e tyre shënoi një rënie prej 31.4%.

Rënie në të njëjtën periudhë është shënuar edhe te importi i gazit të lëngshëm, me 20.2% në sasi dhe 41.2% në vlerë.

Rritje e lehtë vjetore është shënuar në vlerën e naftës së importuar dhe derivateve të naftës me 5.6%, megjithëse ka pasur një rënie të volumit të tyre me 2.2%. Pjesa më e madhe e gazit natyror të importuar në BE në tremujorin e dytë të vitit ose 43.5% e ka

origjinën në Norvegji, e ndjekur nga Algjeria me 21.6% dhe Rusia me 15.5%.

Sa i përket gazit të lëngshëm, 46% është importuar nga SHBA, e ndjekur nga Rusia me 16.8% dhe Katari me 11.9%. SHBA-të janë eksportuesi kryesor i naftës dhe produkteve të naftës në BE me një peshë prej 15.1%, përpara Norvegjisë me 14.1% dhe Kazakistanit me 11.7%.

<https://ec.europa.eu/eurostat>



BE KALENDAR / tetor 2024

1. Mbledhje e Këshillit për Punë të Jashtme, 14/10/2024, Bruksel;
2. Mbledhje e Këshillit për Punë të Përgjithshme, 15/10/2024, Bruksel;
3. Sesioni Plenar i Parlamentit Evropian, 7-10/10/2024, Strasbur.

Lidhje të dobishme për publikimet elektronike të BE-së:

- <https://publications.europa.eu/en/home>
- <https://europa.eu/european-union/documents-publications>
- <http://www.europarl.europa.eu/visiting/en/brussels/parlamentarium>



## KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

### BE QENDRA E KUVENDIT

adresa: „11 Tetori“ nr. 10, Shkup, 1000

telefon: +389 2 3 11 22 55 lokal 414

faks: +389 2 3 182 277

E-posta: nsei@sobranie.mk

Zyra 019

---

[www.sobranie.mk](http://www.sobranie.mk)

---

*Projekti IPA për "Asistencë teknike për Kuvendin" u zbatua në Kuvend në periudhën nga janari 2011 deri në qershor 2012, qëllimi i përgjithshëm i të cilit ishte forcimi i kapaciteteve institucionale të Kuvendit dhe në këtë mënyrë përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies së tij ndaj qytetarëve. .*

*Në kuadër të projektit IPA është ofruar asistencë financiare dhe profesionale për ngritjen e një qendre të BE-së në Parlament.*

*Qëllimi i krijimit të Qendrës së BE-së është t'u ofrojë deputetëve në Kuvend dhe Shërbimit akses më të mirë në informacione lidhur me çështjet e BE-së.*

*Qendra e BE-së është organizativisht në kuadër të Sektorit Mbështetës të Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian dhe monitorimin e Integritimit Evropian.*

*Qendra e BE-së ka një bibliotekë me libra dhe botime nga fusha të ndryshme të politikave evropiane.*

